



PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT

2018-2023

Kolegji Universitar “Wisdom”

*Adresa: Rr.Medar Shtylla (Komuna e Parisit), Tiranë, Shqipëri,
Website: www.wisdom.edu.al
Tel: 042200063*

PËRMBAJTJA

KREU I

Historiku

..... 2

KREU II

Kurrikulat dhe programet e lëndëve

..... 3

KREU III

Misioni i Kolegjit Universitar “Wisdom”

..... 4

KREU IV

Struktura organizative e KU “Wisdom”

..... 6

KREU V

Misioni i Kolegjit Universitar “Wisdom” në kuadër të Strategjisë Afatgjatë të Zhvillimit

..... 10

KREU VI

Prioritetet në kuadër të Strategjisë Afatgjatë të Zhvillimit të Kolegjit Universitar “Wisdom”

..... 11

KREU VII

Objektivat strategjike të Kolegjit Universitar “Wisdom”.

..... 19

I. Historiku

Kolegji Universitar “Wisdom” është themeluar nga shoqëria “Wisdom” sh.p.k. e njohur me vendimin Nr. 14905, datë 17.05.1996, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi bazën e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.672, datë 27.09.2006, me të cilin është dhënë leja për studimin në distancë në degët shkenca bankare dhe të sigurimeve dhe shkenca politike, si dhe me Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr.254, datë 27.02.2008, është dhënë leja për zhvillimin e programeve të studimit të ciklit të parë me kohë të plotë në fakultetin e drejtësisë dhe atë të psikologjisë. Me Urdhër Nr.412 datë 25.08.2011 të Ministrit të MASh është miratuar riorganizimi i Shkollës së Lartë Universitare Jopublike “Wisdom University” me dy fakultete, Fakulteti i Drejtësisë dhe Fakulteti i Shkencave Ekonomike e Shoqërore. Programet Bachelor në Drejtësi dhe në Psikologji janë akredituar me sukses mbi bazën e vendimit Nr. 150, datë 18.02.2011 të Këshillit të Akreditimit të APAAL, me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 188, datë 25.04.2011. Me Vendim të Këshillit të Akreditimit Nr. 128, datë 03.12.2010 dhe me Urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 241, datë 31.05.2011, janë miratuar që të hapen programet e studimit në:

I.

- a. Master i Shkencave në “E Drejta Civile dhe Tregtare;
- b. Master i Shkencave në “E Drejta Penale”;
- c. Master i Shkencave në “E Drejta Publike dhe Administrative”.

II.

- a. Bachelor në “Menaxhim-Biznes”;
- b. Bachelor në “Marketing Komunikim”;
- c. Bachelor në “Financë-Bankë”.

Me Urdhër Nr.355, datë 25.10.2015 të Ministrit të MAS është bërë akreditimi institucional i saj. Me Vendim Nr. 6, datë 03.02.2017 të Senatit Akademik bëhet riorganizimi i Shkollës së Lartë Universitare Jopublike “Wisdom University”, duke u kthyer në Kolegj Universitar, sipas nenit 20, të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”,

me emërtimin *Kolegji Universitar "Wisdom"*. Gjatë vitit akademik 2016 – 2017 në KU "Wisdom" u realizua procesi i akreditimit periodik të programeve Bachelor në Drejtësi dhe Bachelor në Psikologji. Procesi i vlerësimit të jashtëm është realizuar nga Agjensia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e cila ka përcjellë nëpërmjet shkresës me Nr. 213 Prot. të datës 17.07.2017 edhe Vendimet e Bordit të Akreditimit:

1. Vendim i BA Nr.56, datë 10.07.2017 "Për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të parë, Bachelor në "Psikologji", të KU "Wisdom"
2. Vendim i BA Nr.57, datë 10.07.2017 "Për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të parë, Bachelor në "Drejtësi", të KU "Wisdom".

Akreditimi Institucional nga agjencia britanike "Quality Assurance Agency"

Gjatë vitit akademik 2016-2017 KU "Wisdom" i'u nënshtrua procesit të akreditimit institucional nga agjencia britanike "Quality Assurance Agency" në bashkëpunim me Agjensinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë në RSH.

Vlen të theksohet se IAL- ynë e ka vlerësuar maksimalisht këtë proces duke e trajtuar me seriozitet si dhe duke marrë të gjitha hapat e duhura për mbarëvajtjen e procesit por edhe dorëzimin e dokumnetacionit të kërkuar brenda të gjitha afatet e parashikuara në Legjislacionin për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë.

Angazhimi dhe përkushtimi i Institucionit në këtë proces u finalizua me akreditimin me sukses, Vendimi i BA Nr.103 Dt. 10.11.2017 "*Për akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë, Kolegji Universitar "Wisdom"*".

II. Kurrikulat dhe programet e lëndëve

Kurrikulat dhe programet e lëndëve janë hartuar nga specialistët më të njohur në vend, në bashkëpunim me specialistë të huaj në përputhje të plotë me kërkesat e legjislacionit në fuqi në RSh, me Deklaratën e Bolonjës, me standardet më të mira të tjera ndërkombëtare, sipas treguesve të përcaktuar nga Shoqata Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA).

Po ashtu, një ndër objektivet e tjera kryesore të Kolegjit Universitar “Wisdom” është respektimi, mbrojtja dhe promovimi i parimeve dhe rregullave të etikës së kërkimit shkencor, lirisë akademike dhe i autonomisë së institucioneve të arsimit të lartë, në përputhje me Deklaratën e Limës mbi Lirinë Akademike dhe Autonominë e Institucioneve të Arsimit të Lartë të vitit 1988, si dhe Deklaratën Dar es Salaam mbi Lirinë Akademike dhe Përgjegjësinë Shoqërore të Akademikëve të vitit 1990.

III. Misioni i Kolegjit Universitar “Wisdom”

Misioni i Kolegjit Universitar “Wisdom” i cili nisi veprimtarinë në vitin akademik 2008-2009, është përgatitja e individëve të kualifikuar, formimi i një klase drejtuese, moderne e të lirë, që do të mundesojë Shqipërinë dinjitoze në familjen europiane, në formësimin e një komuniteti të drejtë dhe rezultativ. Misioni i sipërpërmendur është konceptuar në harmoni të plotë me misionin e përgjithshëm të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, të shprehur në nenin 2, pika c të ligjit Nr. 80/2015, “*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*”, të ndryshuar, me standardet europiane, Kartën e Bolonjës, si dhe me veçantitë dhe risitë që synon të sjellë ky institucion në vendin tonë dhe më gjerë.

Për të përmbushur misionin dhe rolin që ka si institucion i arsimit të lartë, në dobi të shoqërisë, ku zhvillon aktivitetin e tij, Kolegji Universitar “Wisdom”, kryen aktivitete të shumëllojshme në fushën e mësimdhënies, rritjes së cilësisë dhe standarteve të programeve të studimit të ofruara, zhvillimit të mëtejshëm të kërkimit shkencor, rritjes së bashkëpunimit me Insitucione të tjera të arsimore, qendra kërkimore-shkencore, si dhe realizimin me sukses të proceseve akredituese qoftë në nivel programesh ashtu edhe në nivel institucional.

- Kolegji Universitar “Wisdom” është një institucion jopublik që garanton liri akademike, respekton detyrimet ligjore të përcaktuara shprehimisht në Ligjin për

Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, në këtë Statut, si dhe aktet që janë të detyrueshme përgjithësisht për institucionet e arsimit të lartë.

- Kolegji Universitar “Wisdom” ka për mision zhvillimin e arsimit dhe shkencës, në shërbim të lirisë e diversitetit të ideve, për ndërtimin dhe konsolidimin e shoqërisë demokratike dhe shtetit ligjor, për zhvillimin e ekonomisë, për rritjen e mirëqënies e dinjitetit njerëzor, të realizuara me veprimtari të ligjshme dhe transparente.
- Kolegji Universitar “Wisdom” garanton shprehjen e lirë të ideve shkencore, kulturore, politike, sindikale e fetare, duke mos lejuar hallka organizative e aktivitete të partive politike e komuniteteve fetare, përveç atyre me karakter shkencor e arsimor. Traditat më të mira morale, kulturore, historike, arsimore dhe shkencore të vendit, janë baza e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor të ndërthurura me standartet dhe arritjet më të mira botërore përgjithësisht e ato europiane, në veçanti.
- Kolegji Universitar “Wisdom” ka për qëllim t’u japë studentëve një edukim cilësor, duke integruar rezultatet e një kërkimi shkencor të vlefshëm, që t’i shërbejë dijes së shoqërisë shqiptare nëpërmjet mësimdhënies, kreativitetit, përdorimit të arritjeve më të mira të shkencës, si dhe partneriteteve me tregun e punës e atyre ndërkombëtare.
- Të jetë një qendër për zhvillimin e dijes në shoqërinë shqiptare, një qendër ekselence në formimin akademik të studentëve tanë, një qendër ekspertize të specializuar në fushën e studimeve juridike, shoqërore dhe ekonomike, si dhe njëqendër ekselence për kërkimin shkencor bazë dhe të zbatuar.

Kolegji Universitar “Wisdom” ka për qëllim:

- Të ofrojë studime të plota universitare të ciklit të parë, të ciklit të dytë, studime të integruara në drejtësi dhe veprimtari mësimore e trajnuese profesionale, në

përputhje me Kartën e Bolonjës dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

- Të kryejë studime dhe kërkime shkencore në fushën e shkencave juridike, ekonomike dhe të psikologjisë dhe jo vetëm.
- Të kryejë kualifikimin shkencor pasuniversitar, kurse të specializimit dhe kurse të kualifikimit afatshkurtër dhe afatgjatë për juristë, psikologë, ekonomistë dhe persona të fushave të tjera në programe studimi ndërdisiplinorë.
- Të sigurojë cilësi të lartë në mësimdhënie dhe mësimnxënie, duke zbatuar metoda të avancuara e moderne të mësimdhënies, ndër të tjera nëpërmjet nxitjes së të mësuarit aktiv, duke përdorur teknika, materiale dhe përvoja të universiteteve të zhvilluara perëndimore dhe nëpërmjet zbatimit të kriterëve më të larta të mësimdhënies dhe mësimnxënies për stafin akademik dhe për studentët.
- Të caktojë objektiva të qarta për çdo program, se çfarë duhet të dijë dhe çfarë do të jetë në gjendje të bëjë pas përfundimit të programit.
- Të vendosë një lidhje të fortë dhe funksionale me komunitetin në përgjithësi dhe veçanërisht me administratën shtetërore dhe komunitetin e biznesit nëpërmjet arritjes së një partneriteti të përhershëm shumëfunksional etj.

Për arritjen e misionit dhe qëllimit Kolegji Universitar “Wisdom” ka këto objektiva:

- Arritjen e cilësisë së lartë në të gjitha fushat e aktiviteteve akademike dhe të kërkimit shkencor;
- Mbajtjen e një stafi akademik të shquar me vlera dhe aftësi të larta profesionale;
- Cilësinë e lartë në proceset akademike dhe të infrastrukturës së institucionit;

- Pajisjen e studentëve të diplomuar me edukimin më të mirë dhe mundësi që ata të rrisin dijet në vazhdimësi;
- Ndërtimin e urave të bashkëpunimit kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar;
- Krijimin e një mjedisi nxitës e zhvillues për stafin akademik, punonjësit dhe studentët;

IV. Struktura organizative e KU “Wisdom”

Sipas Vendimit Nr. 6, datë 03.02.2017 të Senatit Akademik bëhet riorganizimi i Shkollës së Lartë Universitare Jopublike “Wisdom University”, duke u kthyer në Kolegji Universitar, sipas nenit 20, të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, me emërtimin Kolegji Universitar “WISDOM”.

Kolegji Universitar “Wisdom” përbëhet nga struktura akademike dhe struktura administrative, e cila është pjesë përbërëse e statutit të KU “Wisdom”. Organi më i lartë drejtues akademik është Senati Akademik. Organi më i lartë drejtues administrativ është Bordi i Administrimit.

Autoritetet drejtuese akademike janë rektori, drejtuesi i njësisë kryesore dhe drejtuesi i njësisë bazë. Organe të tjera akademike janë asambleja e personelit akademik dhe komisionet e përhershme. Autoritetet drejtuese administrative janë: administratori i institucionit dhe administratori i njësisë kryesore.

Organe kolegjinale të tjera janë: rektorati, dekanati, këshilli i etikës.

Struktura akademike

Kolegji Universitar “Wisdom” përbëhet nga dy njësi kryesore. Njësitë përbërëse të Kolegjit Universitar “Wisdom” janë strukturuar sipas nenit 22, të Ligjit Nr.80/2015, Fakulteti i Drejtësisë dhe Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore me njësitë bazë.

Struktura akademike e Kolegjit Universitar “Wisdom”, është:

- a) Senati Akademik

- b) Rektori
- c) Rektorati
- d) Këshilli i Etikës
- e) Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
- f) Komisioni për garantimin e standartëve të cilësisë
- g) Komisioni për mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe kurrikulën
- h) Komisioni për marrëdhëniet me studentët, publikun dhe kordinimin.


Fakulteti i Drejtësisë me tre njësi bazë,

- a) Departamenti i të Drejtës Publike
- b) Departamenti i të Drejtës Private
- c) Njësia e Kërkimit Shkencor dhe Mardhënieve me Jashtë.

Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore, me tre njësi bazë,

- a. Departamenti i Ekonomisë
- b. Departamenti i Psikologjisë
- c. Njësia e Kërkimit Shkencor dhe Mardhënieve me Jashtë.

Organigrama e Kolegjit Universitar "Wisdom"



V. Misioni i Kolegjit Universitar “Wisdom” në kuadër të Strategjisë Afatgjatë të Zhvillimit.

Në realizimin e misionit të saj, në kuadër të Strategjisë afatgjatë të zhvillimit, Kolegji Universitar “Wisdom”, do të veprojë në respekt të të drejtave themelore të njeriut të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Kartat, Deklaratat, dhe Konventat europiane dhe ndërkombëtare. Kolegji do të promovojë zhvillimin e lirë të studimit, të procesit mësimor dhe të kërkimit shkencor, bashkëpunimin në shkallë të gjerë me institucione të arsimit të lartë dhe të kulturës kombëtare dhe ndërkombëtare, hapjen ndaj komunitetit shkencor kombëtar dhe ndërkombëtar, bashkëpunimin me administratën shtetërore, raportin e frytshëm bashkëpunues me ndërmarrjet dhe bizneset, me botën e punës dhe të profesioneve dhe me veprimtaritë jofitimprurëse.

Kolegji Universitar “Wisdom”, është e pavarur nga çdo lloj orientimi ideologjik, politik apo fetar; vepron në përputhje dhe në respekt të parimeve kushtetuese dhe të dispozitave ligjore në fuqi, garanton lirinë e studimit, të mësimdhënies dhe të kërkimit të lirë shkencor. Institucioni ynë aspiron përmbushjen e misionit të tij arsimor në frymën e lirisë dhe të respektit të dinjitetit human të pluralizmit të ideve, të trasparencës së procedurave, si dhe promovon mendimin e lirë të pedagogëve dhe studentëve duke u siguruar mundësi të barabarta për punësim dhe studim. Misioni në kuadër të planit strategjik të zhvillimit do të përqendrohet në:

- Të krijojë, të zhvillojë, të përhapë, të konsolidojë dhe të mbrojë një bazë të gjerë dhe të përshtatshme dijesh në shërbim të vendit me anë të mësimdhënies, të kërkimit shkencor, si dhe të shërbimeve të tjera në shkencat juridike, ekonomike dhe shoqërore në përshtatje me zhvillimet shoqërore dhe ekonomike në vend.
- Të kontribuojë në zhvillimin e shoqërisë dhe promovimin e standardeve të demokracisë nëpërmjet edukimit dhe arsimimit të studentëve për një jetë qytetare aktive.
- Të kontribuojë në zhvillimin ekonomik të vendit në përgjithësi dhe atij rajonal në veçanti nëpërmjet formimit dhe krijimit të një brezi studentësh të kualifikuar dhe të aftë për të përballuar sfidat.

- Të ndihmojë brezat e ri në përmbushjen e aspiratave të tyre për zhvillim dhe arsimim.
- Të ridimensionojë arsimin universitar dhe zhvillimin e programeve kërkimore shkencore.

VI. Prioritetet në kuadër të Strategjisë Afatgjatë të Zhvillimit të Kolegjit Universitar “Wisdom”

A. Prioritetet në mekanizmat e sigurimit të cilësisë:

Kolegji Universitar “Wisdom” e cilëson dhe konsideron procesin e zhvillimit dhe konsolidimit të mekanizmave aktuale të sigurimit të cilësisë të një rëndësie jetike në funksion të zhvillimit afatgjatë dhe të qëndrueshëm të këtij Institucioni;

Kolegji Universitar “Wisdom” ushtron veprimtarinë e tij në bazë të parimeve të Procesit të Bolonjës, standardeve për sigurimin e cilësisë në Hapsirën Evropiane të Arsimit të Lartë, Planit Strategjik të Zhvillimit të cilësisë si dhe politikave të përgjithshme të Kolegjit për sigurimin e cilësisë;

Prioritetet e Kolegjit Universitar “Wisdom” në funksion të zhvillimit të mekanizmave të sigurimit të standarteve dhe cilësisë janë:

- Integrimi i kërkimit shkencor me procesin e mësimdhënies;
- Sigurimi i cilësisë më të lartë në mësimdhënie dhe mësimnxënie;
- Zhvillimi dhe përshtatja e kurrikulës me nevojat e tregut të punës dhe perspektivat e zhvillimit të vendit;
- Zbatimi i metodave të avancuara e moderne të mësimdhënies ndër të tjera nëpërmjet nxitjes së të mësuarit aktiv, duke përdorur teknika, materiale dhe përvoja të universiteteve të zhvilluara perëndimore;
- Zbatimi i kritereve më të larta të mësimdhënies dhe mësimnxënies për stafin akademik dhe për studentët;
- Përafrimi i planeve mësimore dhe programeve të lëndëve me standardet

ndërkombëtare të mirënjohura perëndimore;

- Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe qendrat e kërkimit;
- Shkëmbimi i përvojave në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor;
- Nxitja e punës kërkimore tek stafi dhe mbështetja e stafit për punën kërkimore, si dhe sigurimi i pjesëmarrjes së stafit akademik në aktivitete ndërkombëtare shkencore;
- Bërja të mundur ardhjen pranë institucionit tonë të profesorëve të huaj, si profesorë vizitorë për shkëmbinim e përvojave dhe për zhvillimin e orëve mësimore për programet e studimit Master i Shkencave në kuadër të programeve të lëndëve.
- Konsolidimi dhe forcimi i metodave të ushtrimit të kontrollit të brendshëm të cilësisë së mësimdhënies

B. Prioritetet në procesin e mësimdhënies

- Kolegji Universitar “Wisdom” e cilëson dhe konsideron procesin mësimor si një nga prioritetet më të rëndësishme të tij duke vënë në funksion të tij maksimumin e burimeve njerëzore e financiare si dhe mjetet dhe metodat më efikase administrative e institucionale.
- Mësimdhënia është arsyeja kryesore për ekzistencën e një institucioni arsimor. Pikërisht për këtë arsye, institucioni ynë ka si objektiv konceptimin dhe organizimin e përgjithshëm të procesit të mësimdhënies në funksion të një mësimnxënie sa më të mirë, rritjen e vazhdueshme të cilësisë së formimit të studentëve, duke u ofruar atyre dijet, metodat dhe teknikat më bashkëkohore të mësimdhënies dhe duke nxitur mendimin kritik në formulimin e opinioneve mbi problematikat sipas fushave përkatëse të studimit;
- Kolegji Universitar “Wisdom” ushtron veprimtarinë e tij në bazë të parimeve të Procesit të Bolonjës, standardeve për sigurimin e cilësisë në Hapsirën Evropiane

të Arsimit të Lartë, politikat dhe procedurat e Kolegjit për sigurimin e cilësisë, monitorimi dhe vlerësimi periodik i programeve të studimit, vlerësimi i studentëve, cilësia e stafit akademik, mbështetja e studentëve, stafit akademik, kërkimi shkencor etj.

C. Prioritetet në kualifikimin e stafit akademik

Kolegji Universitar “Wisdom” angazhon në kërkimin shkencor profesorë me tituj dhe grada si pjesë të Stafit Akademik, duke u kujdesur njëkohësisht që në këtë proces të përfshijë gradualisht e me standartet e duhura brezin e ri të pedagogëve me synimin në rritjen dhe kualifikimin e mëtejshëm të tyre. Ndër indikatorët e kualifikimit të stafit akademik do të jenë :

- Gradat dhe titujt shkencorë;
- Eksperienca në fushën e mësimdhënies;
- Eksperienca profesionale;
- Botimet akademike;
- Kualifikimet ekstra kurrikulare.

D. Prioritetet në Kërkimin Shkencor

- Kolegji Universitar “Wisdom” angazhon në kërkimin shkencor profesorë me tituj dhe grada pjesë e Stafit Akademik, duke u kujdesur njëkohësisht që në këtë proces të përfshijë gradualisht e me standartet e duhura brezin e ri të pedagogëve si dhe studentët e ekselencës të cilat kanë interes dhe fokus në kërkimin shkencor;
- Kolegji Universitar “Wisdom” e shikon aktivitetin dhe angazhimin e stafit akademik të saj në kërkimin shkencor si një hapësirë e rëndësishme për formimin më të mirë akademik e shkencor të tyre, si një mënyrë për përdorur

dijet dhe njohuritë akademike të tyre në funksion të sfidave të demokratizimit të shoqërisë por edhe si një mënyrë për të rritur prezencën dhe angazhimin në shoqërinë shqiptare;

- Kolegji Universitar “Wisdom” duke marrë në konsideratë rolin parësor të kërkimit shkencor dhe për rëndësinë parësore për zhvillimin e mëtejshëm të shkencës në funksion të zhvillimit të vendit, etj., do të organizojë në mënyrë periodike aktivitete shkencore dhe do të përqendrohet: në hartimin dhe zbatimin e projekteve të ndryshme shkencore, në përkrahjen e projekteve të kërkimeve individuale apo kolektive të stafit akademik, në realizimin e lidhjes së kërkimit shkencor me procesin mësimor, në kultivimin dhe forcimin e aktiviteteve të kërkimit shkencor, në vendosjen e marrëdhënieve bashkëpunuese me institucione të tjera të arsimit të lartë dhe ato të kërkimit shkencor në veçanti, vendase dhe të huaja;
- Kolegji Universitar “Wisdom” dhe Administratori përcaktojnë çdo vit akademik një fond të konsiderueshëm financiar në fushën e kërkimit shkencor dhe projekteve të ndryshme që shohin të angazhuar stafin akademik të Kolegjit duke u kujdesur që të sigurojë një efikasitet maksimale në këtë drejtim;
- Kolegji Universitar “Wisdom” do të organizojë konferenca dhe seminare shkencore, duke siguruar hapësira botimi të punëve kërkimore, duke ruajtur bashkëpunim me universitete dhe duke promovuar vlerat studimore përmes dhënies së çmimeve sipas çdo merite. Në qendër të vëmendjes do të jetë zbatimi i një politike më rigoroze përsa i përket etikës së kërkimit shkencor, sidomos lidhur me respektimin e të drejtave të autorit dhe të probleme të tjera të rëndësishme që kanë të bëjnë me studentët si brezi i ardhshëm i kërkuesve shkencor, si dhe me stafi akademik;

- Kolegji Universitar “Wisdom” e vlerëson performancën në kërkimin shkencor në bazë të indikatorëve dhe formularëve të matjes së performancës në këtë drejtim në përputhje me praktikat më të mira të universiteteve perëndimore, kritereve e treguesve të politikave e standarteve europiane të kërkimit shkencor, vlerësimeve të tregut të punës për vlefshmërinë e kërkimit shkencor, etj;
- Kolegji Universitar “Wisdom” do të vazhdojë botimin revistës shkencore “Wisdom” duke u përpjekur në ndërkombëtarizimin dhe njohjen e saj edhe jashtë kufijve të Shqipërisë si dhe mundësinë e indeksimit me faktor impakti nga Agjensitë Europiane të Vlerësimit dhe Zhvillimit të Kërkimit Shkencor.

E. Prioritetet në bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar

- Kolegji Universitar “Wisdom” synon të bëhet një qendër e rëndësishme rëndese në bashkëpunimin akademik universitar, kërkimin shkencor, aktivitetin botues, dhe promovimin e vlerave zhvilluese e qytetare të arsimit të lartë.
- Marrëdhëniet institucionale që Kolegji Universitar “Wisdom” ka vendosur me universitete të tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë, bëjnë pjesë në historikun e ngjarjeve shkencore të Institucionit tonë, dëshmojnë se ne të kemi një traditë të konsoliduar kërkimore dhe bashkëpunimi të gjithanshëm. Në perspektivën tonë të bashkëpunimit do të jenë universitete të rajonit, europiane dhe ndërkombëtare;
- Kolegji Universitar “Wisdom” mbështet fuqimisht Njësitë për Kërkimin Shkencor dhe Marrëdhëniet me Jashtë si njësi të integruara në strukturat e Kolegjit, të cilat në mënyrë të vazhdueshme do të synojnë lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit si dhe angazhimin e Stafit Akademik dhe Kolegjit si Institucion i Arsimit të Lartë në aktivitete të ndryshme të karakterit shkencor brenda dhe jashtë vendit.
- Fokusimi tek partnerët strategjike dhe diversifikim të lidhjeve;

- Anëtarësimi në shoqata dhe organizma ndërkombëtarë si dhe pjesëmarrje në aktivitete e veprimtari shkencore e kërkimore vendase, rajonale e ndërkombëtare;
- Zbatim dhe thellim të mëtejshëm të marrëveshjeve të lidhuara me universitete partnere brenda dhe jashtë vendit duke synuar thellimin e bashkëpunimit dhe duke bërë të mundur: shkëmbimin e stafit akademik dhe studentëve, organizimin e përbashkët të aktiviteteve shkencore, marrjen pjesë në projekte të përbashkëta të kërkimit shkencor në kuadër të programeve TEMPUS, Horizon 2020; Erasmus +; European Programme for Science and Technology (COST); Rrjeti Euraxess, kualifikimin e stafeve akademike, kryerjen e kërkimeve individuale, bashkëpunimet në kuadër të botimeve në bashkëautorësi etj.

F. Prioritetet mbi Studentët dhe jetën studentore

- Kolegji Universitar “Wisdom” synon rritjen e shkallës së përfshirjes së studentëve në nivelet vendimmarrëse të Kolegjit si dhe sigurimin e përfshirjes së studentëve ekselentë të dy fakulteteve në kërkimin shkencor, në revistën shkencore “Wisdom” apo revista të tjera në kuadër të bashkëpunimeve institucionale, botimet akademike, konferencat dhe workshopet, simpoziumet dhe aktivitetet shkencore studentore, aktivitetin kërkimor etj.⁷
- Programet e studimit do të synojnë formimin e studentëve universitarë dhe pasuniversitarë që janë ambiciozë, të pavarur, studiues me iniciativë, të përgatitur mirë përmes përvojës së tyre për të mësuar nga jeta, nga realitetet e sferës së profesionit dhe nga mundësitë që sjell evropianizimi.

- Kolegji Universitar “Wisdom” synon informatizimin e plotë të të gjithë aktivitetit në funksion të lehtësimit të procedurave për studentët e Kolegjit duke përfshirë këtu bibliotekën, sekretarinë, publikimin e vlerësimit , etj.
- Kolegji Universitar “Wisdom” synon nxitjen e sa më shumë aktiviteteve dhe bashkëpunimeve ndërmjet klubeve dhe grupeve studentore të studentëve të Kolegjit me Institucione të tjera analoge të Arsimit të lartë në Shqipëri, rajon dhe më gjerë.
- Zbatimi i praktikave më të mira dhe rigoroze në procesin e vlerësimit dhe angazhimit të studentëve përmes sigurimit të një procesi vlerësimi transparent dhe rigoroz.
- Kolegji Universitar “Wisdom” synon zgjerimin e vazhdueshëm të aktiviteteve me natyrë social-kulturore e artistike të klubeve studentore që funksionojnë në Kolegj të tilla si “Klubi Ligj dhe Demokraci”, “Klubi i Sipërmarrjes studentore”, “Klubi Jeta Studentore”, “Klubi Vullnetarët në Shoqëri” duke dhënë kontributin e tyre në aktivitete që prekin fushat e ekonomisë, psikologjisë, jurisprudencës, komunikimit, demokratizimit, veprimtarive humanitare etj.
- Kolegji Universitar “Wisdom” do angazhohet maksimalisht në organizimin, mbështetjen dhe fuqizimin e rrjetit tonë të ALUMNI-t, duke i përfshirë gjithnjë e më shumë ALUMNI-t në strukturat e drejtuese dhe organizative të Kolegjit, si dhe duke i angazhuar në aktivitete dhe projekte të Institucionit tonë me institucione të tjera arsimore apo edhe më gjerë.
- Vlerësimi i vazhdueshëm i pedagogëve nga ana e studentëve nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve në mënyrë periodike.
- Kolegji Universitar “Wisdom” përpiqet maksimalisht në përmirësimin e infrastrukturës, shërbimeve dhe llogjistikës në funksion të aktiviteteve dhe nevojave specifike të studentëve, qeverisë studentore dhe klubeve të tyre, në

kuadrin e aktiviteteve dhe angazhimeve mësimore por edhe jashtë mësimore që kryhen gjatë viteve të studimeve universitare.

- Kolegji Universitar “Wisdom” do të angazhohet në zhvillimin e politikave të punësimit për studentët e diplomuar dhe lidhjet me botën e biznesit. Prioritet është zgjerimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit të Kolegjit me Institucionet e ndryshme publike dhe private.

G. Prioritetet në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe infrastrukturën

- Kolegji Universitar “Wisdom” synon mbulimin tërësor të nevojave të studentëve dhe kërkesave të procesit mësimor e shkencor me infrastrukturën e domosdoshme në përputhje me standartet më të mira të cilësisë në nivel kombëtar, rajonal e më gjerë.
- Kolegji Universitar “Wisdom” ka garantuar plotësimin e kushteve sa më cilësore të punës dhe shërbimeve për pedagogët, punonjësit dhe administratën e saj në përputhje me standartet më të plota në këtë drejtim, objektiv do të jetë rritja e cilësisë në zyra, mjedise, njësitë e shërbimeve personale, sistemin e ngrohjes dhe ftohjes, teknologjisë së ruajtjes dhe shpërndarjes së informacionit etj.
- Kolegji Universitar “Wisdom” synon informatizimin e plotë të gjithë aktivitetit duke përfshirë këtu rektoratin, fakultetet, departamentet, bibliotekën, sekretarinë e përgjithshme, etj.
- Kolegji Universitar “Wisdom” synon garantimin brenda standarteve maksimale të kërkuara për shërbime që kanë të bëjnë me garantimin e sigurisë në ambjentet e brendshme të Kolegjit, masat për funksionimin e sistemit kundra zjarrit apo fenomeneve të tjera natyrore, garantimin e zbatimit të ligjit anti-duhan, etj.

VII. Objektivat strategjike të Kolegjit Universitar “Wisdom”.

- Kolegji Universitar “Wisdom” synon të jetë një Institucion i Arsimit të Lartë jo masiv në numër studentësh dhe programesh studimi të ofruara, por cilësor duke kombinuar rritjen e kujdesshme të numrit të studentëve me ruajtjen e standarteve më të mira cilësore akademike e pedagogjike për të nxjerrë studentë cilësorë në të dy cikleve të studimit të tij.
- Kolegji Universitar “Wisdom” synon të ketë eficiencë maksimale në organizimin Institucional dhe funksionimin e strukturave;
- Mësimdhënia, mësimnxënia dhe kurrikulat mësimore, veprimtaria hulumtuese, botuese dhe kërkimi shkencor do të jenë prioritet i të gjitha strukturave të Kolegjit Universitar “Wisdom” në këtë 5 vjeçar ;
- Zbatim dhe thellim të mëtejshëm të marrëveshjeve të lidhuara me universitete partnere brenda dhe jashtë vendit duke synuar thellimin e bashkëpunimit dhe duke bërë të mundur: shkëmbimin e stafit akademik dhe studentëve, organizimin e përbashkët të aktiviteteve shkencore, marrjen pjesë në projekte të përbashkëta të kërkimit shkencor në kuadër të programeve TEMPUS, Horizon 2020; Erasmus +; European Programme for Science and Technology (COST); Rrjeti Euraxess, kualifikimin e stafeve akademike, kryerjen e kërkimeve individuale, bashkëpunimet në kuadër të botimeve në bashkëautorësi etj.
- Kolegji Universitar “Wisdom” synon zgjerimin dhe ofrimin e programeve të reja të studimit, në përputhje me kërkesat e tregut të punës si dhe nevojat e zhvillimit perspektiv të vendit. Gjatë këtij 5 vjeçari do të shihet mundësia e ofrimit të programeve të Ciklit të Tretë të Studimeve, master ekzekutiv dhe studime doktorale.

- Kolegji Universitar “Wisdom” synon përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm të burimeve njerëzore dhe të rritjes së cilësisë së programeve të ofruara;
- Kolegji Universitar “Wisdom” e shikon aktivitetin dhe angazhimin e stafit akademik të saj në kërkimin shkencor si një hapësirë e rëndësishme për formimin më të mirë akademik e shkencor të tyre, si një mënyrë për përdorur dijet dhe njohuritë akademike të tyre në funksion të sfidave të demokratizimit të shoqërisë por edhe si një mënyrë për të rritur prezencën dhe angazhimin në shoqërinë shqiptare;
- Kolegji Universitar “Wisdom” synon informatizimin e plotë të gjithë aktivitetit duke përfshirë këtu rektoratin, fakultetet, departamentet, bibliotekën, sekretarinë e përgjithshme, etj.
- Me qëllim rritjen e qëndrueshmërisë financiare Kolegji Universitar “Wisdom” do të angazhohet në gjetjen e rrugëve dhe mënyrave alternative të sigurimit të të ardhurave, në sajë të bashkëpunimit me Institute të Kërkimit Shkencor, pjesëmarrjes në projekte të ndryshme kombëtare apo ndërkombëtare dhe aktivitete të tjera ekonomike dhe tregtare në të cilat do të angazhohet shoqëria Wisdom sh.p.k.
- Kolegji Universitar “Wisdom” në funksion të rritjes së standarteve dhe cilësisë së procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies krahas aspekteve të tjera, do të shtojë sasinë e teksteve fizike në Bibliotekë, me tituj të lidhur me programet mësimore që zhvillohen në këtë IAL.
- Kolegji Universitar “Wisdom” do të fokusohet në përmirësimin e infrastrukturës, shërbimeve dhe llogjistikës në funksion të aktiviteteve dhe nevojave specifike të

studentëve, qeverisë studentore dhe klubeve të tyre, në kuadrin e aktiviteteve dhe angazhimeve mësimore por edhe jashtë mësimore që kryhen gjatë viteve të studimeve universitare. Gjatë këtij 5 vjeçari do të jetë prioritet krijimi i infrastrukturës së përshtatshme për aksesin e personave me aftësi të kufizuara në procesin mësimor.

- Kolegji Universitar “Wisdom” do të angazhohet në zhvillimin e politikave të punësimit për studentët e diplomuar dhe lidhjet me botën e biznesit. Prioritet është zgjerimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit të Kolegjit me Institucionet e ndryshme publike dhe private.

Tiranë më/...../2017

REKTORI

Prof. Dr. Lush PERPALI